



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR

VENDIM

Nr. 3720 prot

Ballsh më 16/07 / 2026

Nr. 07 datë 16 / 07 / 2026

“Për miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB Nr.12 datë 24.02.2020, Neni 22, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 16 / 07 / 2026;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 22 / 07 / 2026.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet relevante për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

(Klodian Shehaj)

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

(_____)

Kryetari i Këshillit Bashkiak

(Wadim Selen)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK MALLAKASTËR

Nr. 3722/ prot.

Ballsh më 16.07.2026

Lënda: Njoftim për zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit të Bashkisë Mallakastër.

- ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË MALLAKASTËR

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neni 53 pika 4, neni 56 pika 2, shkronja “a”, në mbështetje të Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkiak, dhe mbledhjes së mbajtur nga kryesia e këshillit, njoftoheni se mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Mallakastër do të mbahet në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit pranë Bashkisë ditën e Mërkurë, **datë 22.07.2026, ora 10:00**, me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes më datë 30.06.2026.
3. **Projektvendim Nr.39:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.

Komisioni për shqyrtim: Komisioni Juridik, Komisioni Ekonomisë.

4. **Projektvendim Nr.35:** Për miratimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve në Bashkinë Mallakastër 2026-2031.

Komisioni për shqyrtim: Komisioni Juridik.

Mbledhja e komisioneve më datë 21.07.2026 ora 10:00.

KRYETAR KËSHILLI

Nexhmi Sufaj

